

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair ZAGANJORI - Kryesues
Evelina QIRJAKO - Anëtar
Arjana FULLANI - Anëtar
Medi BICI - Anëtar
Andi ÇELIKU - Anëtar

në datën **02.06.2015**, në seancë gjyqësore me prani të palëve, mori në shqyrtim çështjen administrative me **Nr. 03057/2012 Akti**, që u përket palëve:

PADITËS: Halil Murraj
PALË E PADITUR: Prefekti i Qarkut Vlorë
OBJEKTI: Rikthimin në vendin e mëparshëm të punës ose detyrimin e palës së paditur të bëjë pagesën kalimtare në favor të paditësit për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës.
BAZA LIGJORE: Nenet 146 të Kodit të Punës, neni 6 i Ligjit nr. 8661 datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 259, datë 07.02.2011, ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të padisë të paditësit Halil Murraj.
- Detyrimin e të paditurit Prefektura e Qarkut Vlorë ti paguajë paditësit Halil Murraj shpërblimin e menjëhershëm në masën e dy pagave referuese mujore si dhe trajtimin financiar me pagesë kalimtare.
- Pushimin e padisë përse i përket kërimit të paditësit Halil Murraj kundër të paditurit Prefektura e Qarkut Vlorë me objekt rikthimin në vendin e mëparshëm të punës.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të paditurit.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 768, datë 10.07.2012, ka vendosur:

-Lënien në fuqi të vendimit nr. 259, datë 07.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kundër këtij vendimi, ka paraqitur rekurs pala e paditur Prefektura e Qarkut Vlorë, e cila kërkon ndryshimin e vendimit nr. 768, datë 10.07.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. 259, datë 07.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pushimin e gjyqimit të çështjes...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63 të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 768, datë 10.07.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Tiranë, më 02.06.2015

Nr. 11241-03057-00-2012 i Regj. Themeltar

Nr. 00 - 2015 - 1987 i Vendimit (357)